

Autorizimi i qëndrimit për punonjësit me rrogë

Për çfarë bëhet fjalë?

Në Luksemburg, një qytetari me origjinë nga vende të treta i nevojitet një autorizim për të pasur të drejtë të punojë me rrogë.

Bëhet fjalë për një autorizim qëndrimi për një qytetar me origjinë nga vende të treta i cili në territorin e Luksemburgut dëshiron të qëndrojë e të zhvillojë veprimtari pune të paguara me rrogë ose për një qytetar që nuk është me prejardhje nga Bashkimi Europian, i cili ka vetëm qëndrim të ligjshëm në Luksemburg por nuk ka punuar ndonjëherë me rrogë dhe dëshiron të marrë dokument qëndrimi si punëtor me rrogë.

Autorizimi fillestar i qëndrimit që i lëshohet një punëtor me rrogë jep të drejtë pune vetëm në një sektor pune dhe vetëm për një profesion, por te cilido punëdhënës.

Pra, punëtor i është i lirë të ndërrojë punëdhënës.

Autorizimi në fillim është i vlefshëm për një kohëzgjatje prej një viti, në rast ripërtëritjeje ai vlen për dy vjet e pastaj tre vjet. (Procedurat e ripërtëritjes janë shpjeguar me hollësi në fund të këtij dokumenti)

Më pas, vlefshmëria e autorizimit. me çdo ripërtëritje zgjatet për një afat 3 vjeçar.

Ndërrimi i sektorit të punës mund të bëhet vetëm me autorizim 3 vjeçar, në të kundërt duhet të përsëritet procedura fillestare.

Kushtet që duhen plotësuar

Nëse një punëdhënës i cili pasi shpall të lirë një vend pune pranë Administratës së Punësimit, nuk ia del të gjejë një kandidat të përshtatshëm në tregun lokal të punës, mund të lidhë kontratë pune me një qytetar me origjinë nga vende të treta (kini kujdes: puna mund të fillohet vetëm pas marrjes së autorizimit) dhe atëherë duhet që kërkuesi të nisë procedurën e marrjes së autorizimit të qëndrimit për punëtorë me rrogë.

Kërkesa e autorizimit për punëtor me rrogë për një person me origjinë nga vende të treta i cili ende nuk jeton në Luksemburg duhet të paraqitet para hyrjes në territorin e tij.

Si duhet aplikuar

Vendi i punës duhet të jetë shpallur i lirë nga punëdhësi në Administratën për Punësim [ADEM]. Formulari i kësaj deklarate gjendet në sitin e internetit të Administratës për Punësim si edhe në menynë në anën e djathtë.

Kjo deklaratë i mundëson Administratës për Punësim që të verifikojë gatishmërinë konkrete të kërkuesve të punës që gëzojnë të drejtë përparësie në punësim. (Kjo quhet përparësi komunitare).

Më pas, vetë kërkuesi dhe jo punëdhënësi ia drejton kërkesën Ministrisë së Punëve të Jashtme [MAE]. Administrata e Punësimit ka të drejtë që, megjithatë, të ngarkojë një palë të tretë, p.sh. punëdhënësin, me kryerjen e veprimeve të nevojshme. Për këtë nuk ekziston formular që duhet plotësuar.

Punëtori i ardhshëm me rrogë, me prejardhje nga një vend i tretë, duhet t'ia drejtojë kërkesën për autorizim qëndrimi Ministrisë së Imigracionit përpara se të hyjë në territorin e Luksemburgut.

Kjo kërkesë duhet të jetë e shoqëruar me dokumentet që vijojnë:

- një fotokopje e plotë dhe e noterizuar e pasaportës së vlefshme të atij që paraqet kërkesën;
- certifikata e lindjes e atij që paraqet kërkesën;
- dëshmi penaliteti ose dëshmi (deklaratë) nën betim e palës që paraqet kërkesën;
- një curriculum vitae;
- një kopje e noterizuar e diplomave ose kualifikimeve profesionale të atij që paraqet kërkesën dhe, nëse nevojitet, përkthimi i certifikuar, po qe se dokumenti origjinal nuk është hartuar në frëngjisht, gjermanisht apo anglisht;
- një kontratë pune, e datuar dhe e nënshkruar nga ai dhe nga punëdhënësi i tij (në fushën: “data e fillimit të punës” duhet plotësuar: “duke filluar nga data e marrjes së autorizimit të qëndrimit për punëtor me rrogë”.
- dokument që tregon lidhjen eventuale familjare ndërmjet atij që paraqet kërkesën dhe punëdhënësit;
- një letër ku arsyetohet kërkesa

Shënim: Dokumentet duhet të jenë të certifikuara nga autoritetet kompetente lokale të vendit të origjinës, apo të noterizuara nga autoritetet kompetente lokale të vendit të origjinës e të verifikuara nga ambasada përkatëse. Nëse dokumentet nuk janë në gjermanisht, frëngjisht apo anglisht, duhet bashkangjitur përkthimi i certifikuar i bërë nga një përkthyes i betuar.

Formalitetet që duhen kryer në Luksemburg:

Në rast se kërkuesi merr përgjigje pozitive nga autoritetet luksemburgeze, ai ka për detyrë që brenda tri ditësh pune, duke llogaritur nga data e hyrjes në territorin e Luksemburgut, të paraqitet i pajisur me autorizim qëndrimi, te komuna e vendit ku ka ndër mend të qëndrojë, për të kryer deklarin e mbërritjes. Atij do t'i dorëzohet një kopje e deklaratës në vënd të certifikatës së dorëzimit. Me ndihmën e certifikatës së dorëzimit të kërkesës dhe autorizimit të qëndrimit justifikohet rregullshmëria e qëndrimit deri në momentin e lëshimit të dokumentit të qëndrimit për punëtor me rrogë.

Para skadimit të afatit prej tre muajsh, ai do t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Imigracionit për t'u pajisur me dokument qëndrimi për punëtor me rrogë duke paraqitur dokumentet që vijojnë:

- një kopje e noterizuar e autorizimit të qëndrimit që i është lëshuar nga Ministria;
- një kopje e noterizuar e deklaratës së mbërritjes e lëshuar nga komuna;
- një vërtetim mjekësor që dëshmon se ai plotëson kushtet shëndetësore për autorizimin e qëndrimit, i lëshuar nga një mjek i ndodhur në Luksemburg;
- dëshmia mbi zotërimin e një banese të përshtatshme, në rast se kërkohet;
- një fotografi e kohëve të fundit me format 45/35 mm, me pamje të fytyrës së pambuluar, ku koka ka një lartësi minimale prej 20 mm, në plotësim të normave ICAO/OACI;

- vërtetimin e derdhjes/pagesës së taksës prej 30.- euro në llogarinë CCPL n° LU46 1111 2582 2814 0000 (në emër të: Ministère des Affaires étrangères, Direction de l'Immigration; me shënimin: titre de séjour dans le chef de [dokument qëndrimi në emër të]: mbiemri dhe emri i të interesuarit).

Vendimi – afati – apeli

Afati e përgjigjes nga Ministria nuk tejkalon 3 muaj.

Kjo kohë llogaritet që nga momenti i depozitimit të dosjes së plotësuar me të gjithë dokumentet. Një kërkesë jo e plotë nuk do të merret parasysh e do t'i rikthehet të interesuarit.

Një kopje të kërkesës Ministria e Punëve të Jashtme ia dërgon Administratës për Punësim [ADEM], e cila brenda afatit prej 3 javësh kthen një mendim për dosjen.

Në vazhdim dosjen e merr komisioni këshillues i cili ia përcjell mendimin e vet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Më pastaj, Ministria e Punëve të Jashtme vendimin përfundimtar ia dërgon me postë personit të interesuar.

Në rast se përgjigja është negative, personi mund të apelojë pranë Gjykatës administrative. Nëse pas 3 muajsh Ministria e Punëve të Jashtme nuk i është përgjigjur kërkesës, kjo konsiderohet si përgjigje negative dhe mund të paraqitet apel pranë Gjykatës.

Çfarë ndodh me autorizimin tuaj për qëndrim si punëtor me rrogë nëse mbeteni pa punë?

Në rast se personi humb punën, atij i kanoset rreziku që të humbë edhe autorizimin po qe se është pa punë dhe pa të ardhura personale:

- përgjatë 3 muajsh brenda një periudhe 12 mujore (nëse qëndron më pak se 3 vjet)
- përgjatë 6 muajsh brenda një periudhe 12 mujore (nëse qëndron më shumë se 3 vjet)

Ripërtëritja e autorizimit të qëndrimit për punëtor me rrogë

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Imigracionit do t'i dërgojë një letër me postë çdo bartësi të një dokumenti për qëndrim, rreth 2 muaj para skadimit të dokumentit, me qëllim që bartësin e tij ta rikujtojë se autorizimi i qëndrimit së shpejti do të përfundojë. Në këtë letër do të përmenden formalitetet që duhet plotësuar për të kryer ripërtëritjen.

Formulari i kërkesës për ripërtëritjen e autorizimit të qëndrimit për punëtor me rrogë mund të gjendet në sitin e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme [MAE] si edhe në menynë në anën e djathtë.

Duhet të bashkangjiten dokumentet që vijnë:

- një fotokopje e noterizuar e pasaportës së vlefshme;
- një fotokopje e kontratës së punës, e datuar dhe nënshkruar si duhet, si edhe vërtetimi i regjistrimit për Sigurimin social;
- një certifikatë rezidence;
- dëshmi penaliteti e marrë kohët e fundit;
- një fotografi e kohëve të fundit me format 45/35 mm, me pamje të fytyrës së pambuluar, ku koka ka një lartësi minimale prej 20 mm, në plotësim të normave ICAO/OACI;

- vërtetimin e derdhjes/pagesës së taksës prej 30.- euro në llogarinë CCPL n° LU46 1111 2582 2814 0000 (në emër të: Ministère des Affaires étrangères, Direction de l'Immigration; me shënimin: titre de séjour dans le chef de [dokument qëndrimi në emër të ...]).

Ripërtëritja e parë

- Për ripërtëritjen e parë, nëse plotësohen kushtet, dokumenti i qëndrimit është i vlefshëm:
- për një periudhë 2 vjeçare,
- për një profesion të vetëm të çdo punëdhënës dhe
- vetëm për një sektor pune.

Ripërtëritja e dytë

Për ripërtëritjen e dytë si edhe për çdo ripërtëritje që vijon, dokumenti i qëndrimit është i vlefshëm:

- 3 vjet
- për të gjitha profesionet dhe
- për të gjithë sektorët e punës.

Keni dëshirë ta ndërroni sektorin e punës ku jeni punësuar

Për marrjen e autorizimit për ndërrimin e sektorit të punës para ripërtëritjes së dytë të dokumentit të qëndrimit, punëtori – qytetar me origjinë nga një vend i tretë duhet ta rifillojë procedurën dhe të marrë leje për një ndërrim të tillë me autorizim të ri.

Informacione të ndryshme – Është mirë t'i dini

Punëtorëve që kanë një leje ende të vlefshme pune të kategorisë A ose B (lejet A, B, C ekzistojnë nën sistemin e vjetër sipas ligjit të vitit 1972) të lëshuar sipas ligjit të vjetër nuk u nevojitet autorizim plotësues për t'u punësuar te çdo punëdhënës në të njëjtin profesion dhe në të njëjtin sektor pune.

Punëtorëve që kanë leje pune të kategorisë C, të lëshuar sipas ligjit të vjetër, nuk u nevojitet autorizim plotësues për t'u punësuar te çdo punëdhënës, në çdo profesion dhe sektor pune.

Kujdes: Ky tekst është vetëm një përmbledhje e hartuar nga ASTI asbl. Vetëm teksti i ligjit është i vlefshëm.